



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:076383

Datë: 29.08.2019

Numri i dokumentit: 00483414

**P.nr.111/19**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Ylberza Gllogjani, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.V, K. Pejë, për veprë penale, **"Lëndim i lehtë trupor"**,parashikuar nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të përgjithshme, PP/II-nr.66/19 dt.15.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datë 29.07.2019, nënë prezencën e Prokurores se Shtetit, Ardiana Veselit, të pandehurit L.V., mbrojtësin e tije av. Gzim Kollqakut nga Peja dhe te dëmtuarit SH.K. K-Pejë, me dt.02.08.21019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**L. V.**, i lindur më ..., K. Pejë, ku edhe banon, i biri i B. V. dhe nënës K. V., e gjinisë S., i martuar, baba i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, student i kriminalistikes, merret me afarizëm, me nr. personal ....., me nr. tel....., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt. 26.10.2018 rreth orës 19:30, ne vendin e quajtur "M...." ne ..., Komuna e Pejës, me dashje personit tjetër i shkakton Lëndime te lehta trupore me dëmtim te përkohshëm te shëndetit dhe atë te dëmtuarit SH. K. ne atë mënyre qe ditën kritike, derisa ne këtë vend po mbaheshin zgjedhje, aty shkon i pandehuri i cili me pare kishte mosmarrëveshje me prindin e te dëmtuarit, dhe e godet me grushte ne fytyre dhe ne vesh te duke i shkaktuar Lëndime te lehta trupore me pasoja te përkohshme ne shëndet.

-me çka ka kryer veprën penale **"Lëndim i lehte trupor"**, parashikuar nga neni 188 par. 1 nen par 1.4 te KPRK-se

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 7, 8 par 1, 9, 10 par 1, 17 par 1, 21, 41,42 par 1 nën par 1.1,43,46,73,74 dhe 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, dhe nenin 285, 326, 359, 360,361,365,366,453 të KPPK-së, të akuzuarit e:

## **G J Y K O N**

- Me dënim me gjobë në shumë prej 850 (tetëqind pesëdhjetë) euro.  
Dënimi me gjobë ka për tu ekzekutuar në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.
- Nëse i pandehuri refuzon apo dështon ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë gjykata këtë dënim do ta zëvendësoj me dënim burgimi duke llogaritur një ditë burgimi shumë prej 20 euro.
- Në emër të shpenzimeve të procedurës penale detyrohet të paguaj shumë prej 30 euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 25 euro dhe në emër të kompensimit të viktimave shumë prej 30 euro.
- Pala e dëmtuar SH. (Haxhi) K. për kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- E të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i përgjithshëm, ka ngrit aktakuzën PP/II-nr.66/19 dt.15.02.2019, ndaj te pandehurit L. V. nga Fsh. ..., K. Pejë, për vepër penale “Lëndim i lehtë trupor” nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me date 11.07.2019, ne prezencë te prokurorit te shtetit, dhe te pandehurit, i cili u njoftua me të drejtat e tij, me aktakuzën dhe provat kundër tij dhe pas kësaj prokurori lexoj aktakuzën kundër të njëjtit, me ç'rast i pandehuri u deklarua i pafajshëm.

Pasi që i pandehuri nuk e pranoi fajësinë, gjykata të njëjtin e njoftoj që brenda afatit 30 ditësh ka të drejtë të parashtoj kundërshtimet e veta apo kërkesën për hedhje të aktakuzës, por i pandehuri nuk e parashtoj një kërkesë të tillë.

Gjykata seancën e shqyrtimit kryesor e caktoi me dt.31.07.2019, ku në prani të prokurores së shtetit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të tij, pas njoftimit me pasojat dhe privilegjet e pranimit të fajësisë, i pandehuri u deklarua se e pranon fajësinë për veprën penale që i vihet në barë.

Pas deklarimit te pandehurit se e pranon fajësinë, mendimit te prokurorit, të dëmtuarit dhe mbrojtësit të pandehurit, të cilët nuk e kundërshtuan pranimin e fajësisë nga i pandehuri, Gjykata konstatoj se i pandehuri pranon fajësinë ne mënyre vullnetare dhe pa asnjë presion. I

pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248 par. 1 të KPPRK-se janë përmbushur. Andaj, gjykata aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Duke pas parasysh se gjykata, ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin kryesor dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par 1 dhe 2 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por është marr vetëm fjala përfundimtare e palëve në procedurë, dhe pas deklarimit të të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar me shqyrtimin e dënimit.

**Në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit ka deklaruar se:** PTHDP në Pejë me dt.,15.02.2019 ka ngritë aktakuzë kundër L. V. nga Fsh. ..., me numër personal ..., për shkak të veprës penale "Lëndim i lehtë trupor" nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së, dhe pasi që sot i pandehuri e pranoj fajësinë, me çrasis edhe unë u pajtova me pranimin e fajësisë dhe pasi që e njëjta u bë me vullnet të lire, i njëjti u pendua për atë që ka ndodhur, i kërkoj falje edhe palës së dëmtuar, mbes në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik të saj, i propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit si rrethanë lehtësuese ta ketë parasysh edhe pranimin e fajësisë si dhe ndaj tij të shqiptoj një dënim më të lehtë.

**Në fjalën përfundimtare të dëmtuari SH.K. ka deklaruar se:** E mbështes fjalën përfundimtare të prokurores, duke shtuar se i pandehuri është recidivist i veprave penale, ndaj tij të shqiptohet dënim meritor me sanksion penal maksimal. Parashatroj kërkesë pasurore juridike.

**Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se:** Ashtu si potencoi edhe prokurorja e çështjes se i mbrojturi im në shqyrtimin e sotëm kryesor duke shpreh keqardhje dhe pendim të thellë, bëri pranimin e fajësisë, që ky pranim ashtu siç parashihet edhe me ligj, të merret si rrethanë lehtësuese, i propozoj gjykatës që përveç pranimit të fajësisë si rrethanë lehtësuese të merret parasysh edhe keqardhja dhe kërkim falja e sinqertë që është bërë në këtë shqyrtim gjyqësor, si dhe të merret për bazë që i mbrojturi im është mbajtës i vetëm i familjes, është prind i tre fëmijëve, është student në fakultetin e kriminalistikës, vepra ka ndodh aty për aty pa ndonjë paramendim të më parshëm, gjithashtu i mbrojturi im asnjë herë më parë nuk ka qenë i dënuar për asnjë vepër penale dhe duke marr parasysh mos durueshmërinë e deri tanishme dhe të gjitha rrethanat tjera lehtësuese i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim ti shqipërohet një dënim me gjobë apo i kushtëzuar e që jam shumë i bindur se edhe me këtë lloj dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit.

**Në fjalën përfundimtare të pandehurit ka deklaruar se:** I bashkëngjitem fjalës përfundimtare të mbrojtësit tim. dua të theksoj se unë nuk kam asnjë vepër tjetër penale, unë nuk jam recidivist dhe asnjë herë nuk kam qenë i dënuar me një aktgjykim të gjykatës. I propozoj gjykatës që të më shqiptoj një dënim sa më të butë.

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës si dhe me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit L. V., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale "Lëndim i lehtë trupor" nga neni 188 par 1 nën par 1.4 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim te nenit 73 te KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për te pandehurin gjykata gjeti se i pandehuri ka treguar sjellje korrekte, e ka pranuar fajësinë për veprën qe e ka kryer. Këto rrethana kjo gjykatë i ka pranuar si rrethana lehtësuese ne dobi te te pandehurit. Rrethana rënduese për te pandehurin gjykata nuk gjeti.

Andaj, duke vlerësuar këto rrethana, Gjykata ne kuptim te nenit 73 te KPRK-së te pandehurin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimit, me te cilin do te arrihet qëllimi i dënimit.

Gjykata ka ardhur ne përfundim se dënimi i shqiptuar te pandehurit është në përputhje me shkallen e përgjegjësisë penale te tij dhe me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura te shoqërisë.

Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim është në përputhje me kushtet qe i ka i pandehuri dhe me bindjen se i ka kushtet për përmbushje. Dënimi i tillë do te shërbej, për arritjen e qëllimit te dënimit, ne pengimin e te pandehurit, ne kryerjen e veprave penale ne te ardhmen, por ai ndikoj edhe si preventive e përgjithshme për personat tjerë qe te përmbahen nga kryerja e veprave penale ne përputhje me nenin 41 te KPRK-se.

Vendimin për shpenzimet procedurës gjyqësore në shumë prej 30 euro, dhe të paushallit gjyqësor në shumë prej 25 euro, gjykata e mori në përputhje me nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 te KPPRK-se, bazua ne shpenzimet qe, janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Vendimin në emër të taksës, për kompensim e viktimave të krimit, në shumë prej 30€, gjykata e mori në komfor nenit 39 par.1,2,3 pika 3.1 të Ligjit, bazua në atë se i ka kushtet për përmbarim.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar qe kërkesën pasurore juridike ta realizoj ne kontest civil u morr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 370 të KPPRK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHË  
P.nr.111/19 më datë 02.08.2019.**

Sekretarja Juridike

Gj y q t a r i,

---

**Ylberza Gillogjani**

---

**Dr.sc. Murat Hulaj**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë te drejte te parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.